## PARTNERËT

Njësia për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese në UP, bashkëpunon ngushtësisht me një numër të organizatave, duke përfshirë ato vendore rajonale dhe ndërkombëtare.

### 1) Partnerët vendor:

- Qendra për Inovacione dhe Transfer të Teknologjisë – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- K-CIRT – Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Teknologji dhe Arsim të Lartë

### 2) Partnerët ndërkombëtar

MONTAN UNIVERSITÄT WWW.UNILEOBEN.AC.AT

UNIVERSITY OF OXFORD

SAPIENZA UNIVERSITÀ DI ROMA

wus austria right to education

AUSTIN POCK + PARTNERS

### 3) Emrat e qendrave tjera R&D (3x)

Universiteti i Malit të Zi

Universiteti i Sarajevës

Ss.Cyril dhe Methodius Maqedoni

Kontakti: Dr. Hysen Bytyçi
Menaxher i Njësisë për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese
Rr. "Nëna Terezë", Ndërtesa e Rektoratit
10000 Prishtinë – Kosovë
hysen.bytyqi@uni-pr.edu
www.uni-pr.edu

*Ky projekt është financuar me mbështetjen e Komisionit Evropian. Ky botim reflekton vetëm pikëpamjet e autorit dhe Komisioni nuk mund të mbahet përgjegjës për ndonjëpërdorim i cili mund të bëhet prej informacionit të përmbajtur.*

European Commission TEMPUS

European Commission TEMPUS

R Capacities D

# Njësia për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese

## Kapacitetet për Hulumtim dhe Zhvillim



www.uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës

## Hyrje

Universiteti i Prishtinës është ofruesi më i madh publik i arsimit të lartë dhe forca lëvizëse kryesore në përpjekje për të nxitur, konsoliduar dhe ruajtjen e përsosmërisë në hulumtime dhe inovacione në Kosovë.

Për shkak të shumë faktorëve, Universiteti i Prishtinës aktualisht nuk është plotësisht në gjendje të arrijë potencialin e tij në hulumtime dhe zhvillim teknologjik, në mënyrë që të nxisë një zhvillim të fortë sipas kohës dhe njohurive konkurruese të bazuara në ekonomi.

Megjithatë, vitet e fundit u bënë përpjekje për të treguar një aftësi gjithëpërfshirëse për të përformuar më mirë, për të demonstruar dhe për të ngritur vazhdimisht performancën në zhvillim dhe hulumtim.



## Shërbimi ynë orientohet në këto fusha:

- Shkencat Natyrore dhe Matematikore;
- Veterinari dhe Bujqësi;
- Mjekësi;
- Filologji;
- Ndërtimtari dhe Arkitekturë;
- Ekonomi;
- Drejtësi;
- Filozofi;
- Inxhinieri Mekanike;
- Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike;
- Arte
- Xehetari dhe Metalurgji.

## Objektivat e RPSO

Qëllimi ynë në RPSO është për të lehtësuar aktivitetet kërkimore dhe transferimin e njohurive. Ne bashkëpunojmë me partnerë vendor, ndërkombëtar dhe institucione e organizata tjera që ndihmojnë:

- Hulumtuesit në sigurimin e fondeve dhe në negocimin e bashkëpunimeve;
- Mbështetjen në këmbimin e njohurive;
- Ndërtimin e partneriteteve në mes të komunitetit akademik, qeveritar, biznesit dhe organizatave bamirëse;
- Për të nxitur financimin nga jashtë të aktiviteteve hulumtuese;
- Ngritja e shkallës së aplikimeve për grante në njësit akademike të UP-së
- Të sigurojë ndihmë operacionale dhe strategjike tek njësitë akademike të UP-së.

## Sfidat e ardhshme:

Në dritën e zbatimit të suksesshëm të Procesit të Bolonjës në Universitetin e Prishtinës, janë disa probleme që lidhen me kërkimin shkencor, në të cilat ky institucion është i fokusuar në:

- Një lidhje më e mirë në mes mësimdhënies dhe kërkimit;
- Zhvillimi i një infrastrukture më të mirë kërkimi për fusha të veçanta në të cilat hulumtimet themelore mund të kryhen.
- Përpjekje për të zënë hapin me përparimet shkencore.
- Zhvillimi i strategjisë për hulumtime.
- Zhvillimi i bashkëpunimit të mëtejshëm kërkimor dhe ndërkombëtarizimi i një ndër çështjeve sektoriale të Procesit të Bolonjës.



## Njësia për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese

Krijimi i njohurive nëpërmes aktiviteteve kërkimoro-shkencore është një kriter kyç në punën e suksesit të sistemit të arsimit të lartë. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për t'u përballë me një epokë të re kërkimore të shekullit 21 dhe për të kompensuar kohën e humbur gjate viteve të 90-ta dhe për të rritur veprimtarinë kërkimore shkencore në nivel institucional, në 19 dhjetor 2008 Universiteti i Prishtinës ka marrë vendim për formimin e Njësisë për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese. Njësia operon në kuadër të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe vepron që nga qershori i vitit 2009. Njësia për Mbështetjen e Projekteve Hulumtuese bashkëpunon ngushtë me çdo Njësi Akademike të UP-së duke siguruar dhe ofruar shërbime dhe instrumente për hulumtuesit. Këto shërbime dhe instrumente kanë për qëllim të veçantë në nxitjen e bashkëpunimit me industrinë dhe institucionet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.





## "Krijimi i Kapaciteteve dhe Instrumenteve për Hulumtim dhe Zhvillim,për nxitjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe Ekonomisë."

Projekti ka për qëllim trajtimin imediat të nevojave për hulumtime individuale në vendet e mëposhtme: Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë , Maqedoni dhe Mali i Zi. Universitetet më të rëndësishme në çdo vend do të sigurojnë mbështetje intensive, duke ndihmuar ata në krijimin e R&D kapaciteteve dhe instrumenteve të cilat ofrojnë përfitime afatgjate. Qëllimi është t'u mundësojmë Universiteteve të ushtrojnë një rol qëndron në sistemin kombëtar të R&D, gjegjësisht duke forcuar rolin e institucioneve të arsimit të lartë si një të tërë, për të vepruar si një forcë shtytëse e zhvillimit ekonomik rajonal.

## Objektivat kryesore:

Vlerësimi i gjendjes ekzistuese të R&D-së
Zhvillimi dhe zbatimi gjithëpërfshirës i strategjisë së R&D
Krijimi i Qendrave Shërbyese R&D
Zbatimi i pilot projekteve të R&D-së
Miratimi i qëndrueshmërisë dhe kontrollit të cilësisë